



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

---

C.nr.534/18

GJYKATA THEMELORE NE PEJE, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Afërdita Mulhaxha, ne çështjen juridike-kontesitore te paditëses N. M., nga Peja, të cilën e përfaqëson F. GJ., avokat në Pejë, kundër te paditurës K.- DKA, në Pejë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit D. S.-G., avokate në Prishtinë, për kompensimin e pagave përcjellëse dhe shpërblimin jubilar, vlera e kontestit: 3.835,40€, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, të mbajtur me dt.16.12.2019, në prezencë të autorizuarit të paditësit dhe përfaqësueses së të paditurës, pas së cilës me dt.03.01.2020, merr dhe shpall këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e paditëses N. M., nga Peja.

DETYROHET e paditura K.P-DKA në Pejë, që paditëses N. M. nga Peja, që në emër kompensimit të pagave përcjellëse në pension dhe shpërblimit jubilar për tri(3) paga, t'ia paguaj shumën totale në lartësi prej 3.835,40€, më kamatë ligjore prej 8%, nga dita e nxjerrjes se aktgjykimit dt.03.01.2020, e deri në pagesën definitive, e në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin te përmbarimit më dhunë.

DETYROHET e paditura K.P-DKA në Pejë, që paditëses N. M. nga Peja, t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 570€, në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit më dhunë.

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarit të tij, më dt.29.05.2018, ka parashtruar padi kundër të paditurës KP-DKA, në Pejë, për kompensimin e pagave përcjellëse në pension dhe shpërblimin jubilar.

Në padinë e ushtruar i autorizuari i palës paditëse ka theksuar se paditësja ka qenë mësimdhënëse në Shkollën e Mesme të Ulët „L...”, në Pejë, dhe me vendimin e MPMS Departamenti i Pensioneve-Zyra e Pensioneve, në Pejë nr.562/18, të dt.18.04.2017, është pensionuar me dt.11.04.2017, duke potencuar se meqenëse paditësja ka dal në pension, sipas nenit 35, par.8 dhe 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, ajo përfiton shpërblim jubilar dhe pagesën përcjellëse, nga punëdhënësi i fundit, dhe pasi që paditësja ka 46 vite përvoje punë, asaj i takojnë 4 shpërblime jubilarë në vlerë prej 150% të një page bazë (paga bazë 430€), që do të thotë shumën totale prej 2580€ (4×645€), dhe tri(3) paga përcjellëse të mesatares së katër(4) pagave të fundit të punonjësit (paga mesatare 475€), që do të thotë shumën totale prej 1.425€ (3×475€), apo nga të dy bazat gjithsej 4.005€.

Paditësja me kërkesë i është drejtuar të paditurës për pagesën e shpërblimeve jubilarë dhe pagave përcjellëse, mirëpo e paditura e ka refuzuar kërkesën e saj me arsyetim se Ministria e Financave nuk ka bërë alokimin e mjeteve financiare, për këtë i autorizuari i palës paditëse i ka propozuar gjykatës që të caktoi seancën e shqyrtimit kryesor dhe pas administrimit të provave ta aprovoi kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar.

I autorizuari i paditëses gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, pasi që në bazë të provave të procedurës në shqyrtim kryesor është vërtetuar themelësia e kërkesëpadisë të paditëses, të precizuar në parashtrësën e saj të dt.31.10.2019, duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit financiar, përkitazi me lartësinë e kërkesëpadisë, ndërsa baza është vërtetuar nga dispozitat përkatëse të Kontratës së Përgjithshme Kolektive dhe Marrëveshjes Kolektive për Arsim të vitit 2014, të cilat kanë qenë në fuqi në momentin e pensionimit të paditëses, me dt.11.04.2017, andaj i njëjti i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses të precizuar, ta aprovojë në tërësi si të bazuar dhe të obligojë të paditurën t'i paguaj shpenzimet procedurale në shumë të përgjithshme prej 570€, dhe atë për hartimin e padisë 104€, për taksë gjyqësore 41€, për hartimin e parashtrësës për precizim 104€, për dy(2) përfaqësime-shumën prej 270€, dhe për ekspertizë shumën prej 51€. I autorizuari i paditëses ka potencuar se shpërblimet që janë vlerësuar nga e ekspertit janë bërë në bruto të pagave për shkak se sipas Ligjit për Tatimin e të Ardhurave Personale, këto paga jubilarë dhe përcjellëse i nënshtrohen tatueshmërisë në lartësi sikurse është paraparë me ligjin e lartë cekur dhe se i mbetet paditësit që të i shlyej këto detyrime tatimore.

E paditura nëpërmjet të autorizuarës së saj, me përgjigje në padi, të bërë me dt.12.03.2019, e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar, me arsyetim se të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv në këtë çështje kontestimore, pasi që paditësja padinë dhe kërkesëpadinë e saj duhet ta drejtoj ndaj Ministrisë së Arsimit(MASHT), Ministrisë së Punës dhe Mirëqenës Sociale(MPMS), dhe Ministrisë së Financave(MF), si garantues të përmbushjes së obligimeve financiare që rrjedhin nga marrëveshje Përgjithshme Kolektive, të dt.18.06.2014, të nënshkuara mes OEA, Aleancës Kosovare të Biznesit, BSPK dhe Qeverisë së Kosovës-Ministria e Punës dhe Mirëqenës Sociale dhe se nga Kontrata e Kolektive e dt.18.04.2017, për punëtorët e arsimit para universitar të cilën e kanë nënshkruar e MASHT-i dhe SBASHK-u, si një pjesë përbërëse e marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës. Përkatësisht, neni 46 par.2 i Kontratës Kolektive përcakton se, MASHT dhe SBASHK angazhohen bashkërisht në MF-në për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve financiare për Komunitet dhe Kosovës me qëllim të reA.zimit të buxhetit të nevojshëm të përcaktuar në nenin 35 paragraf 5.7, dhe brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare. Ka potencuar se në asnjërën nga këto dokumente ligjore nuk është nënshkruar e paditura, andaj si mund të ketë ndonjë obligim ligjor nga kërkesëpadia e paditëses. Lidhur me kërkesën për pagesë të pagave jubilarë, ka theksuar se një kërkesë e tillë është e parashkruar, rrjedhimisht paditësja e ka humbur afatin ligjor, kjo sepse paga jubilarë rrjedh çdo 10 vjet, kurse afati ligjor për një kërkesë të tillë është 3 vjet pas kA.mit të çdo periudhe dhjetë(10) vjeçare.

Ndërsa gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se e kundërshton përllogaritjen nga ana e ekspertit financiar, sepse eksperti ka bërë përllogaritjen në bazë të pagës bruto, ndërsa reA.sht përllogaritja duhet të bëhet në bazë të pagës neto, ku si dëshmi janë transferet e pagave në llogarinë bankare në shkresat e lëndës, ku paga neto është në lartësi prej 477,34€, që nënkupton që në total janë 1.432,02€, po ashtu e njëjta vlen edhe për shpërblimin jubilar, gjithsejtë 2.864,04 €, krejt kjo bazuar në llogarinë bankare e cila është si dëshmi në shkresat e lëndës, e në veçanti në detyrat e ekspertit financiar, andaj e njëjta i ka propozuar gjykatës që ta refuzoi këtë lartësi për shkak të përllogaritjes dhe përllogaritjen e kamatës sepse kamata përllogaritet përsëri edhe nga përmbartuesi në procedurën e përmbartimit.

Gjykata për vërtetimin e plote të gjendjes faktike në këtë çështje juridike-kontestimore, zhvilloj procedurën e provave ku u administrua si provë: vërtetimi për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit të kontribut paguesve i dt.18.04.2017, për paditësen; kërkesa e parashtruar nga paditësja për t'ia aprovuat pagat përcjellëse dhe jubilarë e dt.07.05.2018; vërtetimi i lëshuar nga shkolla „L...”, i dt.24.06.2018, që vërteton se paditja ka qenë në marrëdhënie punë në këtë shkollë; përgjigjja në kërkesën e paditësit nga e paditura; llogaria bankare e paditëses; librezat e

anëtarësisë në SBASHK; ekspertiza e ekspertit financiar A. SH., ecc.dip., e dt.15.10.2019, si dhe deklaratimet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku e në lidhmëni njëra me tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurës Kontestimore, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv, të këtij aktgjykimi, për faktin se:

-nga provat e pa kontestuara është vërtetuar fakti së paditësja N.M. nga Peja, ka qenë e punësuar pranë të paditurës, në vendin e punës mësimdhënëse gjer me dt.11.04.2017, kur edhe i ka pushuar marrëdhënia e punës sipas fuqisë së ligjit, për shkak të arritjes së moshës së pensionit.

Pas shqyrtimit të të gjitha provave prezent në lëndë dhe deklaratimeve të palëve ndërgjyqësve e duke u mbështetur në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës dhe Kontratën Kolektive të Arsimit Para universitar Nr.018-2000, dt.11.04.2017, ku me nenin 52 paragraf 1, të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të dt.18.03.2014, shprehimisht përcaktohet se „*I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: 1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një paga mujore të tij; 1.2.për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; 1.3.për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij*”. Me paragrafin 2 të kësaj marrëveshje përcaktohet se: „*Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë, ndërsa në paragrafin 3 të kësaj Marrëveshje përcaktohet se: Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf*”. Me nenin 53 të kësaj Marrëveshje përcaktohet se „*I punësuari, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marr për tre (3) muajt te fundit*”, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e bazuar, dhe duhet aprovuar.

Andaj gjykata vendosi si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura me lartë për arsye se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive, e dt.18.03.2014, ka qenë në fuqi në kohën e pensionimit të paditëses me dt.11.04.2017. Paditësja dhe e paditura në marrëveshjen kolektive janë pajtuar, dhe e kanë shprehur vullnetin e përbashkët që vërtetohet me nënshkrimet e tyre.

Gjykata gjen se marrëveshja është dokument i vlefshëm dhe i zbatueshëm në tërësi Republikën e Kosovës, *fakt i pakontestueshëm sepse marrëveshja është nënshkruar nga autoritetet kompetente, dhe është përcaktuar shprehimisht zbatimi i saj, kush e zbaton dhe ndaj kujt zbatohet, dhe ky obligim duhet të përfundohet sipas marrëveshjes së nënshkruar*, për çka gjykata në një situatë të tillë, vlerëson se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar, ndërsa për lartësinë e kërkesëpadisë gjatë vendosjes ishte me ndikim ekspertiza e ekspertit financiar e dt.15.10.2019, e punuar në mënyrë profesionale nga eksperti financiar A. SH. ecc.dip., të cilës gjatë vendosjes kjo gjykatë i'a fA. besimin dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Gjykata më rastin e vendosje ka vlerësuar edhe pretendimin dhe kundërshtimet e ngritura nga e autorizuarja e të paditurës se padia e paditëses në raport ndaj te paditurës Komuna e Pejës, duhet të refuzohet sepse e njëjta nuk është nënshkruar e Kontratës Kolektive dhe se nëse ka bazë për kompensim atëherë i bien MASHT në Prishtinë, gjykata erdhi në përfundim se Komuna e Pejës, ka legjitimitet real pasiv, që të përgjigjet lidhur me këtë çështje juridike kontestimore.

Gjithashtu gjykata, me rastin e vendosjes pati parasysh kundërshtimet e të paditurës të dhëna në përgjigje në padi e dt.12.03.2019, dhe gjatë shqyrtimit kryesor lidhur me kërkesëpadinë e paditësit, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për të vendosur ndryshe, sepse përgjegjësia siç u cekur më lartë, në rastin konkret bie ndaj të paditurës, dhe pretendimet e të autorizuarës të paditurës janë të pa bazuara sepse Ligji për Arsim Komunal, nr.03/L-068, respektivisht nenin 4, shprehimisht citon se „*Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, sipas legjislacionit në*

*fuqi në lidhje me arsimin publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, nëse mbështetemi në këtë Ligj dhe Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale nenin 16 dhe 17 par.1 pika h), atëherë ky obligim bie ndaj te paditurës Komuna e Pejës, për kompensimi e paditësit”.*

Kundërshtimet e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesëpadisë për pagat jubilarë, për gjykatën nuk ishin me ndikim për të vendosur ndryshe, për faktin se paditëses i është ndërprerë marrëdhënia e punës me dt.11.04.2017, sipas fuqisë ligjore për shkak të mbushjes së moshës mandatore të pensionit që është 65 vjet, ndërsa paditësja padinë në gjykatë për kompensimin e pagave përcjellëse dhe shpërblimin jubilar e ka parashtruar brenda afatit ligjor, respektivisht më dt.29.05.2018, andaj gjykata vlerëson së në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës.

Vlen të ceket se kërkesa e paditësit për shpërblimin jubilar e aprovuar nga gjykata gjenë mbështetje në nenin 52, dhe 53, të Kontratës së Përgjithshme Kolektive, e dt.18.03.2014, e cila ka hyrë në fuqi nga dt.01.01.2015, në bazë të së cilës duhet ta përmbushë punëdhënësi i fundit.

Gjykata vendimin lidhur me kumatën e gjykuar, e mbështet ne dispozitat e nenit 382 te Ligjit Nr. 04/L-77-LMD-se, ku gjykata si moment te fillimit te llogaritjes se kumatës e ka pranuar ditën e nxjerrjes se aktgjykimi më dt.08.01.2020, duke i'a njohur paditëses kumatën ligjore prej 8%, ne tërësi ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 382 par.2 te Ligjit Nr. 04/L-77-LMD-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi duke u mbështetur ne dispozitën e nenit 452 par.1, nenit 463.1 të LPK-së, e sipas tarifës se OAK-ës, në këto shpenzime janë llogaritur: për përpilimin e padisë shuma prej 104€, ne emër të përfaqësimit shuma prej 270€, për dy(2) seanca te mbajtura, e në shumë prej 270€, taksën për padi në shumë prej 41€, për precizimin e kërkesëpadisë shumen prej 104€, si dhe në emër të shpërblimit për ekspert financiar shumën prej 51€, në shumë totale prej 570€.

Nga arsyet e lartcekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË, C.nr.534/18, me dt.08.01.2020.

Gj y q t a r j a  
Afërdita Mulhaxha

#### **KËSHILLA JURIDIKE:**

*Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.*